

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER RIDVANA G. RUÇI**



V2022053240013719979

**DATE 13/01/2022  
NR REP 196**

**VËRTETIM NJËSIE ME ORIGINALIN**

Sot, më datë 13/01/2022, para meje Noteres RIDVANA G. RUÇI, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën KAJO KARAFILI, u paraqit personalisht:

**KËRKUES:** Brikena Hoxha, atësia Selim, amësia Deshira, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Njesia Nr.3 Hoxha Tasim; Nd. 263; H. 1; Ap. 8; Njësia Administrative Nr. 3; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 04/02/1970, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035409509 dhe nr. personal H05204052C. E cila me kerkoi te vertetoj me origjinalin fotokopjen e dokumentit:  
"Vendim i Asamblese se Ortakeve te TRANZIT shpk nr.16; Akt i Themelimit me pergjegjesi te kufizuar A.I.D.A shpk dhe Statuti perkates."

Unë Noterja, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezultoi se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noteres, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



**NOTER**  
**RIDVANA G. RUÇI**



**DECISION OF  
SHAREHOLDERS ASSEMBLY OF TRANZIT SHPK NO. 16**

Today, on 14 December 2021, the Shareholders Assembly of "TRANZIT" SHPK a limited liability company registered in Albania at the National Registration Center under the registration number K91624020M, with its seat at "Rruga e Kavajes, Ndertesa 27, Kati 3, Tirana, Albania" (the "Company"), namely:

1. The company "NCH BALKAN FUND, L.P." an exempted limited partnership registered in Cayman Islands, with registration number MC-15214 and with its seat at PO Box 309 Uglan House, South Church Street, George Town, Grand Cayman, KY1-1104, Cayman Islands ("NCH Balkan").
2. The company "NEW CENTURY HOLDINGS XI, L.P." an exempted limited partnership registered in Cayman Islands, with registration number CR-10711 and with its seat at PO Box 309 Uglan House, South Church Street, George Town, Grand Cayman, KY1-1104, Cayman Islands ("NCH XI").
3. ANDI BALLTA born on 1970, in Tirana, and residing there, with full capacity to act, holder of the Albanian identity card No. 032694651 and personal No H01130033A.
4. The company "MOSCOPOLE Inc." registered in Delaware, USA, and with its seat at Hogan Lovells US LLP, 390 Madison Avenue New York, NY 10017 ("Moscopole").

**Whereas:**

Considering the opportunities that might arise in Albania for private equity investments, especially in the sector of tourism and construction, the shareholders of Tranzit

**Decide**

1. To establish a limited liability company in the Republic of Albania by the name of A.I.D.A. SHPK (the "Company"), on the basis of the corporate data set out in the Founding Act and the Articles of Association, as approved and attached to this resolution.
2. To approve any and all the terms and the provisions of the Founding Act and of the Articles of Association, in the form attached to this resolution.
3. To appoint Mr. Joni Gusho as the administrator and to carry out all the actions to register the Company as required by the applicable law in Albania.
4. The administrator of the Company shall carry out all the actions to register the company with the authorities in Albania, according to the applicable law.

**SHAREHOLDERS OF TRANZIT SHPK**



**NCH BALKAN FUND, L.P.**

Edward C. Parisi

Name: Edward C. Parisi

Title: Vice President of NCH Balkan Associates LLC, the General Partner of NCH Balkan Fund, L.P.

**NEW CENTURY HOLDINGS XI, L.P.**

Edward C. Parisi

Name: Edward C. Parisi

Title: Vice President of Cornerstone Capital Corp., a General Partner of New Century Holdings XI, L.P.

Hung-Shu (Rebecca) Shen

Name: Hung-Shu (Rebecca) Shen

Title: Vice President of NCH Balkan Associates LLC, the General Partner of NCH Balkan Fund, L.P.

Hung-Shu (Rebecca) Shen

Name: Hung-Shu (Rebecca) Shen

Title: Vice President of Cornerstone Capital Corp., a General Partner of New Century Holdings XI, L.P.

**MOSCOPOLE Inc.**

Name:

Title:

[Signature]

**ANDI BALLTA**

[Signature]



**FOUNDING ACT OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY  
A.I.D.A. SHPK**

**Article 1  
Company Name**

- 1.1 The Company name is: A.I.D.A. SHPK ("Company").
- 1.2 In all the documents, invoices, advertisements and publications issued by the Company, regardless of the means for transmission, the name of the Company should be preceded or followed by the following :
  - a) the words "Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" or "SH.P.K"
  - b) its unique identification number (NIPT)
  - c) its registered seat and
  - d) the fact that the Company is under liquidation, if applicable.

**Article 2  
Form of Legal Personality**

The Company is formed as an Albanian legal entity having the legal form of a liability company (shoqeri me pergjegjesi te kufizuar), as provided in the Law Nr. 9901, dt. 14.04.2008, "On the Entrepreneurs and Commercial Companies", as amended (Law on Commercial Companies).

**Article 3  
Legal Seat, Headquarters**

- 3.1. The Company's legal seat is at "Rr. Kavajes" Ndertesa 27, Tirana, Albania.
- 3.2. The Company may move its seat or establish an operative seat in any other location in Albania.

**Article 4  
Company Duration**

The duration of the company is unlimited.

**Article 5  
Company Object**


The scope of the activity of the Company is: Activities related to movable and immovable property on behalf of the Company or third parties, including transactions and management; activities related to investments and development in energy, technology, and other industrial sectors in different areas, such as urban/rural/industrial/tourist, etc.; advisory and consultancy services for these activities or financial undertakings.

**Article 6  
Initial Capital**

- 6.1 The initial registered capital of the Company is ALL 10,000,000 (ten million Lek).

*K.* 1

6.2 The capital is equal to one (1) quota with nominal value of ALL 10,000,000 (ten million Lek).



**Article 7  
Administrator**


The first Administrator of the Company shall be Joni Gusho.

Date: Tirana, 14 December 2021

Shareholder: Tranzit SHPK

Kristina Naumi, Administrator

*Kristina Naumi*  
*Naumi*



**The STATUTE of A.I.D.A. SHPK**  
**CHAPTER I**  
**Formation, Name, Object, Duration and Legal Seat**

**ARTICLE 1**  
**Date of foundation, Name and Founders**

1. Today on 14 December 2021, we the founders, have founded a limited liability company with the name **A.I.D.A. L.L.C.**
2. The Founder of the Company is **TRANZIT SHPK (NUIS K91624020M)**
3. The trade name of the Company is **A.I.D.A. SHPK.**
4. The Company shall earn juridical personality as soon as registered in the National Business Centre (NBC/QKB) according to the Albanian law.

**ARTICLE 2**  
**The Object of the Company**

- (1) The scope of the activity of the Company is: Activities related to movable and immovable property on behalf of the Company or third parties, including transactions and management; activities related to investments and development in energy, technology, and other industrial sectors in different areas, such as urban/rural/industrial/tourist, etc.; advisory and consultancy services for these activities or financial undertakings.
- (2) The Company shall have its own bodies to achieve its goal in compliance with the applicable law in the Republic of Albania.

**ARTICLE 3**  
**Duration**

The duration of the Company is unlimited, starting on the date of registration at NBC (QKB).

**ARTICLE 4**  
**Legal Seat, Website and electronic address**

- (1) The legal seat of the Company is at Rr. Kavajes, Ndertesa 27, Tiranë, Shqipëri. The Company can change it legal seat and/or open other branches in Albania, only according to the decision of the shareholder.
- (2) The Company shall have its official website and electronic address for electronic communication as it will be registred with NBC/QKB.
- (3) Other distinguished signs of the economic activity, electronic address or website maybe registered voluntarily with NBC/QKB.

**CHAPTER II**  
**THE CAPITAL**

**ARTICLE 5**  
**Company Capital**



- (1) The initial capital of the company is 10 million ALL (10,000,000 leke). The initial capital is equal to one (1) quota with nominal value of ALL 10,000,000 (ten million Lek). The initial capital is already paid by the Founder.
- (2) The Shareholder of the Company may increase or decrease the capital according to the applicable law in Albania.
- (3) The book of Shareholder: The Company will maintain a book of shareholders under the care of the administrator of the Company in order to reflect the rights of shareholders and third parties in the shares of the Company.

**ARTICLE 6**  
**Increase and decrease of capital**

- (1) The capital of the company can be increased through the subscription of the parts of the basic capital for contribution in cash, and for the contribution in kind through the appointment from the competent court of an authorized expert for these contributions according to the requirements of the Administrator.
- (2) The majority cannot obligate, under any circumstances, any of the shareholders to increase his contribution in the basic capital of the company.
- (3) The decrease of the capital is allowed by the assembly of the Shareholder, which will take the decision under the same conditions as for the amendment to the Statute.
- (4) In all case the decrease of the capital affects the shareholders to the same extent as their respective parts in the capital.

**ARTICLE 7**  
**Transfer of quotas**

- (1) Quotas and the rights they confer shall be acquired or transfer through:
  - Participation in the authorized share capital at the incorporation of the company;
  - Purchase;
  - Inheritance;
  - Donation;
  - Other ways provided by the Law.
- (2) The parts of the basic capital are freely transferable between shareholders.
- (3) The parts of the basic capital are freely transferable through heritage.

**CHAPTER III**  
**DECISION-MAKING AND DIRECTING ORGANS**

**Article 8**  
**Decision – Making Body**

1. The General Assembly of Shareholders is the only decision-making body of the Company.
2. The General Assembly takes decision for the following topics:
  - a) Setting the business policies;
  - b) Amendments to the Statute;
  - c) Election and dismissal of the Administrators;
  - d) Election and dismissal of independent auditors and liquidators;
  - e) Establishment of remunerations of Administrators and Independent Auditors or Liquidators;

*K.*

- f) Monitoring and supervising the implementation of business policies by the Administrators, including preparation of the annual balance sheets and the performance reports;
  - g) Adoption of the annual statement of accounts and performance reports;
  - h) Increase and decrease of basic capital;
  - i) Division of quotas and annulment of quotas;
  - j) Representation of the company in court and in other proceedings against Administrators;
  - k) Company restructuring and dissolution;
  - l) Adoption of its own rules of procedure;
  - m) Dividends and distribution;
  - n) Other matters set by law or this Bylaw.
3. A shareholder may be represented at the General Assembly by another shareholder or a third person only if authorized in writing.
  4. The Administrator of the company cannot act as a representative of another shareholder at the General Assembly meeting. The authorization shall be issued only for one General Assembly Meeting including the reconvened meeting for the same agenda.

**Article 9**  
**Method of Convening the General Assembly Meeting**

1. The General Assembly Meeting shall be convened by written notice via e-mail, or mail by the administrator or the auditor. The written notice/e-mail shall contain the place, date and hour of the meeting and be delivered together with the agenda to all members not later than 7 days before the scheduled date of the meeting.
2. Where the General Assembly Meeting has not been convened in conformity with Paragraph 1, the General Assembly Meeting may adopt valid decisions only if all the shareholders of the Company agree to take decisions despite the irregularity. When the Company has only one Shareholder, the sole Shareholder can take valid decisions and the above paragraphs do not apply.

**ARTICLE10**  
**Administration**


- (1) The General Assembly shall nominate one or more natural persons as Administrators of the Company. The term of the appointment as defined in the Bylaws cannot exceed 5 years and can be renewed. The General Assembly can issue specific rules and procedures for the nomination, authorities and restriction of the Administrators.
- (2) The Administrators of a parent company according to Article 207 of this Law may not be elected Administrators of a subsidiary and vice-versa. Any election made contrary to this provision is null and void.
- (3) The Administrator of the Company shall be Joni Gusho for a term of three (3) years.

**ARTICLE11**  
**The competencies of the Administrators**

1. The Administrators have the right and obligation to:

*L.*



- 
- a) Manage the Company's business by implementing the policies defined by the General Assembly;
  - b) Represent the company;
  - c) Ensure that the necessary account books and documents are kept accordingly;
  - d) Provide for and sign the annual financial statements of accounts and consolidated accounts and the performance report and present it to the General Assembly for approval together with the proposals for the dividend distribution of profits;
  - e) Create an early warning system with respect to developments threatening the existence of the company;
  - f) File for the registrations and submit the mandatory data of the company according to the Law on the National Registration Center;
  - g) Report to the General Assembly with respect to the implementation of business policies and to the realization of transactions of particular importance for company performance;
  - h) Perform other duties set by law or the Statute.
2. The Administrators are obligated to convey the General Assembly in cases when:
    - a) according to the annual balance sheet or interim accounts reports exists the risk that the assets of the company will not cover up its liabilities within the next 3 months;
    - b) the company proposes to sell or otherwise dispose on the assets amounting to more than 5% of the company's assets resulting in the last certified financial statements;
    - c) the company, within the first 2 years after registration, proposes to purchase assets from a shareholder, whose value amount to more than 5% of the company's assets as per last certified financial statements;
  3. If the Company has more than one Administrator, their competencies and restrictions shall be established by a specific decision of the General Assembly of the Shareholders.
  4. The General Assembly may dismiss the Administrator at any time by ordinary majority. Any claims, related to the compensation of the Administrator, arising from any contractual relationship are governed by the legal provisions in force.

## **ARTICLE 12**

### **Responsibilities of the Administrator**

- 1) The Administrator is individually liable towards the Company or third parties for violations of laws, of the Statute, or for wrongdoings during the administration of the Company.
- 2) Damages to the Company deriving from agreements not approved by the General Assembly, shall be charged to the Administrator and the Shareholder that have concluded the agreement, jointly and severally, depending on the specific case.
- 3) In addition to the general provisions on fidelity as foreseen in Articles 14, 15, 17, 18 of the Law on Commercial Companies, the Administrator shall:
  - a) Perform his duties established by the law and the Statute in good faith in the best interests of the company and the impact of the Company's activity in the environment;
  - b) as a whole which includes the environmental sustainability of its operations;
  - c) Exercise powers granted to him by the law and the Statute only for the purposes established therein;
  - d) Give adequate consideration to matters to be decided;

*K.*

- e) Avoid actual and potential conflicts between personal interests and those of the company;
- f) Perform his duties with professionalism and reasonable care.
- 4) The Administrator during the performance of his duties, is held liable for any action or failure to act reasonably related to the purpose of the Company, unless the action or omission was made in good faith, based upon reasonable inquiry and information; and rationally related to the purposes of the company
- 5) In case when the Administrator acts in violation of his duties and infringes the professional standards according to points 1 and 2 of this Article, he is obliged to compensate the company for any damage which occurred due to the violation, as well as to disgorge any personal profits made by him or the person connected with him, in violation of his duties to the company. The Administrator has the burden of proving compliance with the duties and standards. In case the violation has been committed by more than one of the Administrator, they are jointly and severally liable towards the company.
- 6) The Administrator is obliged to compensate the Company for damages caused, if in breach of the Law "On Commercial Companies", and commit any, but not limited to, the following actions:
  - a) Returns the contributions to shareholders;
  - b) Pays interests or dividends to a shareholder;
  - c) Distributes the company's assets;
  - ç) Allows the company to continue to do business when based on the financial status, the Company is in not able to pay debt;
  - d) Lends Company's assets
- 7) Besides the claim for compensation of damages attributable personally to the administrator, the shareholders individually or jointly, have the right to file criminal charges against the Administrator

**Chapter IV**  
**Financial Year – Expert**

**ARTICLE 13**  
**Financial Year**

The financial year commences on January 1<sup>st</sup> and ends on December 31<sup>st</sup>, of each calendar year. Except for the first financial year, that commences from the date of registration of the company in the National Registration Center, and is closed on December 31<sup>st</sup>.

**ARTICLE 14**  
**Certified Accountant**

1. The certified accountant has the obligation to control the entire accounting documentations of the economic activity of the Company, the annual and the periodic control performed from him in cases when he has been appointed and has performed such duty charged by the Shareholder.
2. At the end of the control, the certified accountant prepares the written report and issues the results of the annual balance sheets, as well as the report for the periodical controls, which is obliged to present and submit in time to the Shareholders for examination and approval as per their voting rights.

*J.*

**Chapter V**  
**Dissolution- Restructuring of the Company**

**ARTICLE 15**

**Dissolution and Liquidation**

1. The Company can be dissolved at any time, under the following circumstances:
  - a. By expiry of the period for which it was established;
  - b) By decision of the General Assembly;
  - c) By bankruptcy procedures;
  - d) If it has not carried out any business activities for two years and has not notified its inactive status in accordance with paragraph 3 of Art. 43 of Law No. 9723 'On the National Registration Centre', as amended;
  - e) By court decision;
2. In this case the Shareholders decide in writing on the method of liquidation of the Company by appointing one or more liquidators, and any documents issued by the Company should have the name of the liquidators and the additional nomination "Company in liquidation".
3. Following the dissolution of the commercial companies, the liquidation procedures in the state of solvency is initiated, unless a bankruptcy procedure has already been filed.
4. The liquidation is carried out by the liquidators on behalf of the Shareholders.
5. When the partners do not take a decision upon the appointment of the liquidators within 30 days after the dissolution, any interested person can address the court to appoint a liquidator.

**ARTICLE 16**

**Restructuring the company Merger- Division**

The company can be divided or merged according to the Decision of the General Assembly of the Shareholders as foreseen in Part IX of the Law no. 9901, dated 14.04.2012 "On the Commercial Companies", as amended.

**ARTICLE 17**

**Applicable Law**

1. The company will carry out its activity in conformity with this Statute and the applicable law in the Republic of Albania.
2. For any matter not foreseen in the Statute, the Law on Commercial Companies, the Civil Code and any other relevant law applies.

**ARTICLE 18**

**Disputes**

Any dispute arising out of or related with the implementation or interpretation of this Statute, as well as any dispute between the Company and third parties, shall be referred to the District Court of Tirana.

Date: Tirana, 14 December 2021

Shareholder: Tranzit SHPK

Kristina Naumi, Administrator

*Kristina Naumi*  
*Naumi*

## VENDIMI I ASAMBLESE SË ORTAKËVE TË TRANZIT SHPK Nr. 16

---

Sot, më 14 Dhjetor 2021, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të "TRANZIT" SHPK, një shoqëri me përgjegjesi të kufizuara e themeluar në Shqipëri dhe e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) K91624020M, me seli në adresën "Rruga e Kavajes, Ndertesa 27, Kati 3, Tirana, Albania" (Shoqëria), përkatësisht:

1. Shoqëria "NCH BALKAN FUND, L.P." shoqëri me partneritet të kufizuar e regjistruar në Ishujt Cayman, me numër regjistrimi MC-15214 dhe seli në adresën PO Box 309 Ugland House, South Church Street, George Town, Grand Cayman, KY1-1104, Cayman Islands ("NCH Balkan").
2. Shoqëria "NEW CENTURY HOLDINGS XI, L.P.", shoqëri me partneritet të kufizuar e regjistruar në Ishujt Cayman, me numër regjistrimi CR-10711 dhe seli në adresën at PO Box 309 Ugland House, South Church Street, George Town, Grand Cayman, KY1-1104, Cayman Islands ("NCH XI").
3. Andi Ballta, lindur në 1970, në Tiranë, me vendbanim në Tiranë, me zotësi të plotë për të vepruar, i pajisur me Letërnjoftimin shqiptar Nr. 032694651 dhe Nr. Personal. H01130033A.
4. Shoqëria "MOSCOPELE Inc", e regjistruar në Delaware, USA, me seli në adresën: Hogan Lovells US LLP, 390 Madison Avenue New York. NY 10017 ("Moscopole").

### Duke:

Konsideruar oportunitetet që mund të lindin në Shqipëri për investimet në kapitalet private, specifikisht në sektorin e turizmit dhe ndërtimit, ortakët e Tranzit:

### Vendosin:

1. Të krijojnë një shoqëri me përgjegjesi të kufizuar në Republikën e Shqipërisë me emrin A.I.D.A. SHPK (Shoqëria), referuar në të dhënat e shoqërisë të percaktuara në Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, sikurse aprovuar dhe bashkëlidhur kësaj rezolute.
2. Të miratojnë të gjitha kushtet dhe parashikimet e Aktit të Themelimit dhe Statutit të shoqërisë, në formatin bashkëlidhur kësaj rezolute.
3. Të emërojnë z. Joni Gusho si administrator i shoqërisë si dhe ta autorizojë të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për të regjistruar shoqërinë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri.
4. Administratori i shoqërisë do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për të regjistruar shoqërinë pranë autoriteteve përkatëse në Shqipëri, në përputhje me legjislacionin në fuqi.




**ORTAKËT E TRANZIT SHPK**

**NCH BALKAN FUND, L.P.**

\_\_\_\_\_  
Nenshkrimi

**Emri: Edward C. Parisi**  
Pozicioni: Zv. President i NCH Balkan  
Associates LLC,  
Partner i Pergjithshem i NCH Balkan  
Fund , L.P.

\_\_\_\_\_  
Nenshkrimi

**Emri: Hung-Shu (Rebecca) Shen**  
Pozicioni: Zv. Presidente e NCH Balkan  
Associates LLC,  
Partner i Pergjithshem i NCH Balkan  
Fund , L.P.

**MOSCOPOLE Inc.**

\_\_\_\_\_  
Nenshkrimi

**NEW CENTURY HOLDINGS XI, L.P.**

\_\_\_\_\_  
Nenshkrimi

**Emri: Edward C. Parisi**  
Pozicioni: Zv. President i Cornestone  
Capital Corp., Partner i Pergjithshem  
i New Century Holdings XI, L.P

\_\_\_\_\_  
Nenshkrimi

**Emri: Hung-Shu (Rebecca) Shen**  
Pozicioni: Zv. Presidente e Cornestone  
Capital Corp., Partner i Pergjithshem  
i New Century Holdings XI, L.P

**ANDI BALLTA**

\_\_\_\_\_  
Nenshkrimi

**AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
A.I.D.A. SHPK**

**Neni 1  
Emri i shoqërisë**

- 1.1 Emri i shoqërisë është A.I.D.A. SHPK ("Shoqëria")
- 1.2 Në të gjithë dokumentet, faturat, reklamat dhe publikimet e Shoqërisë, pavarësisht nga mënyra e transmetimit të tyre, emri i Shoqërisë duhet të shoqërohet nga:
  - a) fjalët "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose "SH.P.K"
  - b) numrin unik i identifikimit të subjektit (NUIS)
  - c) zyra qendrore dhe
  - d) faktin nëse Shoqëria është në likuidim, nëse aplikohet.

**Neni 2  
Forma ligjore dhe Personaliteti Juridik**

Shoqëria është themeluar si një person juridik shqiptar dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërië tregtare", i ndryshuar (Ligji për Shoqëritë Tregtare).

**Neni 3  
Zyra qendrore**

- 3.1 Shoqëria do të ketë zyrat qendrore në adresën "Rr. Kavajës, Ndërtesa 27, Tiranë, Shqipëri".
- 3.2 Shoqëria mund të ndryshojë zyrat qendrore ose të vendosë krijimin e një zyre operacionale në një adresë tjetër në Shqipëri

**Neni 4  
Kohëzgjatja e shoqërisë**

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 5  
Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: Aktivitete lidhur me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në emër të Shoqërisë ose personave të tretë, duke përfshirë transaksione dhe menaxhim, aktivitete lidhur me investime dhe zhvillim në fushën e energjisë, teknologjisë si dhe në sektorë të tjerë industrial si ato urban/rural/industrial/turistik etj. Shërbime këshillimi dhe konsultimi për këto aktivitete ose sipërmarrje financiare.

**Neni 6  
Kapitali fillestar**

- 6.1 Kapitali themeltar fillestar i regjistruar i shoqërisë është ALL 10,000,000 (dhjetë milion Lekë).
- 6.2 Ky kapital është 1 barabarte me një (1) kuote me vlerë nominale ALL 10,000,000 (dhjetë milion Lekë).

**Neni 7**  
**Administratori**

Administratori i pare i Shoqërisë do të jetë z. Joni Gusho.

Datë, Tiranë më 14 Dhjetor 2021

Ortak: Tranzit SHPK

Kristina Naumi, Administrator

(firma)



**STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
A.I.D.A. SHPK**

**KREU I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Zyra qendrore**

**Neni 1**

**Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit**

1. Sot, më 14 Dhjetor 2021, ne, themeluesit, kemi themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të emërtuar **A.I.D.A. SHPK**
2. Themeluesi i Shoqërisë është **TRANZIT SHPK (NUIS K91624020M)**
3. Emri tregtar i shoqërisë është **A.I.D.A. SHPK**
4. Shoqëria do të fitojë personalitet juridik me regjistrimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) sipas legjislacionit shqiptar.

**Neni 2**

**Objekti i veprimtarisë**

1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: Aktivitete lidhur me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në emër të Shoqërisë ose personave të tretë, duke përfshirë transaksione dhe menaxhim, aktivitete lidhur me investime dhe zhvillim në fushën e energjisë, teknologjisë si dhe në sektorë të tjerë industrial si ato urban/rural/industrial/turistik etj. Shërbime këshillimi dhe konsultimi për këto aktivitete ose sipërmarrje financiare.
2. Shoqëria do të ketë organe specifike për të përmbushur objektivat e saj në përputhje me ligjin e aplikueshëm në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 3**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pacaktuar dhe fillon datën e regjistrimit në QKB.

**Neni 4**

**Zyra qendrore, Faqja web dhe adresa elektronike**

1. Shoqëria do të ketë zyrat qendrore në adresën "Rr. Kavajës, Ndërtesa 27, Tiranë, Shqipëri". Shoqëria mund të ndryshojë zyrat qendrore dhe / ose të hapë degë të tjera në Shqipëri, vetëm në bazë të një vendimi të ortakëve të shoqërisë
2. Shoqëria do të ketë faqen web zyrtare dhe adresën elektronike për komunikimin elektronik sikurse do të regjistrohet në QKB.
3. Shenja të tjera dalluese të aktivitetit ekonomik, adresa elektronike ose faqja web mund të regjistrohen vullnetarisht në QKB.

**KREU II**

**KAPITALI**

**Neni 5**

**Kapitali i Shoqërisë**

1. Kapitali fillestar i Shoqërisë është ALL 10,000,000 (dhjetë milion Lekë). Ky kapital është 1 barabartë me një (1) kuote me vlerë nominale ALL 10,000,000 (dhjetë milion Lekë). Kapitali fillestar është parapaguar nga Themeluesit.
2. Ortaku i shoqërisë mund të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin në përputhje me ligjin e aplikueshëm në Shqipëri.



3. Regjistri i ortakëve: Shoqëria do të mbajë një libër/regjister të ortakëve nën kujdesin e administratorit të Shoqërisë me qëllim që të reflektohen të drejtat e ortakëve dhe personave të tretë në kuotat e Shoqërisë.

#### **Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar me anë të kontributeve në para dhe kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga Gjykata kompetente të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së Administratorit.
2. Ortakët në shumicë, nuk mund të detyrojnë, në asnjë rast, ortakët e tjerë të rrisin kontributin në kapitalin themeltar të Shoqërisë.
3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila do të marrë vendimin në të njëjtat kushte si për ndryshimin e Statutit.
4. Në të gjitha rastet, zvogëlimi i kapitalit do të afektojë ortakët në të njëjtën masë sikurse pjesët e tyre respektive në Kapital.

#### **Neni 7 Transferimi i kuotës**

1. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - Pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë;
  - Shitblerjes
  - Trashëgimisë
  - Dhurimit
  - Cdo mënyrë tjetër e parashikuara me ligj.Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.  
Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

### **KREU III Organet Vendimmarrëse dhe Drejtuese**

#### **Neni 8 Organi Vendimmarrës**

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendime lidhur me çështjet e mëposhtëme:
  - a) Hartimin e politikave tregtare;
  - b) Ndryshimin e Statutit;
  - c) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit;
  - d) Emërimin dhe shkarkimin e audituesve të pavarur dhe likujduesve;
  - e) Përcaktimin e shpërblimeve për Administratorin dhe Audituesit e pavarur ose Likujduesit;
  - f) Mbikëqyrjen dhe monitorimin e implementimit të politikave tregtare nga Administratori, përfshirë edhe përgatitjen pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
  - g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
  - h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) Pjesëtimin dhe anulimin e kuotave;
  - j) Përfaqësimin e shoqërisë në Gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratorëve;
  - k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

- l) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjes së Asamblesë;
  - m) Dividendet dhe shpërndarjen;
  - n) Ceshtje të tjera të parashikuara nga ligji ose Statuti
3. Në Asamblenë e Përgjithshme, një ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person i tretë vetëm nëse perfaqësuesi është i pajisur me një autorizim me shkrim.
  4. Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si perfaqësues i një ortaku. Autorizimi mund të jepet vetëm për mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme që përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9**

#### **Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme do të thirret me një njoftim të shkruar të dërguar nëpërmjet adresës elektronike (e-mail), ose me një njoftim të dërguar nëpërmjet postës nga Administratori ose audituesi. Njoftimi i dërguar me e-mail apo postë duhet të përmbajë vendin, datën dhe orën e zhvillimit të mbledhjes dhe të dorëzohet së bashku me rendin e ditës tek të gjithë anëtarët jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes.
2. Nëse mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme nuk është thirrur konform Paragrafit 1, gjatë mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme mund të merren vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët e Shoqërisë aprovojnë marrjen e këtyre vendimeve pavarësisht kësaj parregullsie. Kur Shoqëria ka një ortak të vetëm, ortakët e vetëm mund të marrin vendime të vlefshme dhe paragrafi i mesipër nuk aplikohet.

#### **Neni 10**

#### **Administrimi**

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë në cilësinë e Administratorëve të Shoqërisë. Afati i emërimit, sikurse përcaktohet në këtë Statut, është deri në 5 vjet, me të drejtë riemërimi. Asambleja e Përgjithshme mund të përcaktojë rregulla dhe procedura specifike për emërimin, përgjegjësitë dhe kufizimet e Administratorëve.
2. Administratori i një shoqërie mëmë sipas Nenit 207 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar, nuk mund të emërohet si administrator i shoqërisë bijë dhe anasjelltas. Çdo emërim që është në kundërshtim me këtë parashikim është absolutisht i pavlefshëm.
3. Administratori i shoqërisë është Joni Gusho dhe afati i tij i emërimit është 3 (tre) vjet.

#### **Neni 11**

#### **Kompetencat e Administratorit**

1. Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen të:
  - a) Administronjë Shoqërinë në përputhje me politikat tregtare të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
  - b) Përfaqësojë Shoqërinë;
  - c) Kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të Shoqërisë;
  - d) Përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
  - e) Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kercënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) Kryejë regjistrimet dhe dergojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB);

- g) Raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
  - h) Kryeje detyra të tjera sipas ligjit ose Statutit.
2. Administratorët detyrohen të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme në rastet kur:
    - a) Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston risku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
    - b) Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër mbi aktivitetet të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të Shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
    - c) Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  3. Nëse Shoqëria ka më shumë se një Administrator, kompetencat dhe kufizimet e tyre do të përcaktohen nga një vendim specifik i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve.
  4. Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të thjeshtë të votave, mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë. Çdo pretendim në lidhje me shpërblimin e administratorit, që rrjedh nga një marrëdhënie kontraktore do të rregullohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 12**

### **Përgjegjësitë e Administratorit**

1. Administratori përgjigjet personalisht kundrejt Shoqërisë apo palëve të treta për shkelje të ligjeve, Statutit, apo për gabimet me dashje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.
2. Dëmet ndaj Shoqërisë që rrjedhin nga marrëveshjet e pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme i ngarkohen Administratorit dhe Ortakut që ka finalizuar këtë marrëveshje, bashkërisht ose individualisht, në varësi të rastit.
3. Përveç sa parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14,15,17,18 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqërië tregtare", i ndryshuar, administratori detyrohet të:
  - a) kryejë detyrat e tij, të percaktuara në ligj dhe në statut, në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) si një tërësi që përfshin qëndrueshmërinë mjedisore të operacioneve të saj;
  - c) ushtrojë kompetencat që i janë dhënë nga Ligji dhe statuti vetëm për arritjen e qëllimeve të percaktuara në ligj dhe në Statut;
  - d) vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
  - e) parandalojë dhe mënjojë rastet e konfliktit, aktuale apo potenciale, të interesave personale dhe atyre të Shoqërisë;
  - f) ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.
4. Administratori gjatë realizimit të detyrave të tij, përgjigjet për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
5. Në rastet kur Administratori vepron në kundërshtim me detyrat e tij dhe shkel standardet profesionale sipas pikave 1) dhe 2) të këtij Neni, ai detyrohet të dëmshpërblejë Shoqërinë për dëmin e shaktuar si pasojë e kësaj shkeljeje si dhe të kthejë çdo përfitim personal të përfituar nga ai apo persona të lidhur që janë realizuar nga shkeljet e detyrave të tij. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

6. Administratori detyrohet të dëmshpërblejë Shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse në kundërshtim me dispozitat e Ligji "Për Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, pa u kufizuar, kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividend;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që Shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet.
  - d) huazon asetet e Shoqërisë.
7. Përveç padive për shpërblimin e dëmit që ngrihen personalisht ndaj Administratorit, ortakët, individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër Administratorit.

#### **KAPITULLI IV** **Viti Financiar-Ekspertët**

##### **Neni 13** **Viti financiar**

Viti financiar fillon në 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor, të cdo viti kalendarik. Përbashimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në QKB dhe përfundon në 31 Dhjetor.

##### **Neni 14** **Eksperti kontabel**

1. Eksperti ka detyrimin të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, kontrolli vjetor dhe periodik i ushtruar prej tij në rastet kur ai caktohet dhe kryen këto kontrolli i ngarkuar nga Ortakët.
2. Në përfundim të kontrollit, audituesi i certifikuar përgatit një raport për nxjerrjen e rezultateve të bilancit financiar vjetor, si dhe raportin e kontroleve periodike, të cilat ka detyrim t'i prezantojë dhe dorëzojë në kohë Ortakëve për miratim mbi bazën e të drejtës së votës që kanë.

#### **KAPITULLI V** **Prishja dhe Riorganizimi i Shoqërisë**

##### **Neni 15** **Prishja dhe Likuidimi**

1. Shoqëria mund të priset në cdo kohë, sipas rrethanave të mëposhtme:
  - a) me përfundimin e kohëzgjatjes së Shoqërisë;
  - b) me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit
  - d) nëse shoqëria nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vite dhe nuk është njoftuar pezullimi i statusit sipa sparagrafit 3 të Nenit 43, të Ligjit Nr. 9723 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar
  - e) me Vendim gjyqësor.
2. Në këtë rast, Ortakët vendosin me shkrim mbi mënyrën e likuidimit të shoqërisë duke caktuar një ose më shumë likujdues dhe cdo dokument i lëshuar nga shoqëria duhet të ketë emrin e likujduesve si dhe emërtimin shtesë "Shoqëri në likuidim".
3. Pas prishjes së Shoqërisë, nisin procedurat e likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur ka filluar një procedure falimentimi.
4. Procedura e likuidimit realizohet nga likujduesi i emëruar nga Ortakët.

5. Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likujduesve brenda 30 ditëve pas prishjes së shoqërisë, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet Gjykatës për caktimin e një likujduesi.

**Neni 16**  
**Riorganizimi i Shoqërisë- Bashkimi-Ndarja**

Shoqëria mund të ndahet ose të bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në përputhje me Pjesën IX të Ligjit Nr. 9901, dt. dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërië tregtare", i ndryshuar.

**Neni 17**  
**Ligji i aplikueshëm**

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut dhe ligjin e aplikueshëm në Republikën e Shqipërisë.
2. Për cdo çështje që mund të mos jetë parashikuar në këtë Statut, do të aplikohet Ligji "Per Shoqerite tregtare", Kodi Civil dhe cdo akt tjeter ligjor i zbatueshëm.

**Neni 18**  
**Mosmarrëveshjet**


Gjykimi i mosmarrëveshjeve që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti, si dhe mosmarrëveshjeve ndermjet Shoqërisë dhe palëve të treta, janë në juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Datë, Tiranë më 14 Dhjetor 2021

Ortak: Tranzit SHPK

Kristina Naumi, Administrator

(firma)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER RIDVANA G. RUÇI**



**DATE 13/01/2022  
NR REP 197**

**VËRTETIM PËRKTHIMI**

Unë notere RIDVANA G. RUÇI, anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në rrugën “KAJO KARAFILI”, licencuar nga Ministria e Drejtësisë si perkthyes zyrtare e gjuhës angleze, deklaroj se kam përkthyer njësoj me origjinalin dokumentin , bashkëlidhur këtij vërtetimi, nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.

Ky vërtetim është përpiluar nga ana ime në bazë të nenit 62/j, të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.



**NOTER  
RIDVANA G. RUÇI**

